



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 71, Datë 14 / 08 / 2017

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 73, datë 22.07.2016, të paraqitur nga subjekti ankues, “Ambasada Pink-LGBT Pro Shqipëri”, e përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, A.H kundër M.D, Deputete e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “identitetit gjinor” dhe “orientimit seksual”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Subjekti ankues shpjegon se M.D në fjalën e mbajtur në seancën plenare të datës 07.07.2016 ka pohuar se: *“Sot, jam këtu për të folur në lidhje me një çështje thelbësore, me ndryshimet kushtetuese që po bëhen në kuadër të reformës në drejtësi. Brenda kësaj pakete pa kurrfarë diskutimi, ka hyrë edhe shtegu që të çon në martesat homoseksuale. Tani po pyes F.X, drejtuesin e komisionit të reformës dhe kreun e shumicës në qeveri, E.R: Përse dëshironi që votën time dhe votat e grupit të deputetëve të PDIU-së të jenë kundër? Përse na provokoni dhe përse kaq rëndë? Nëse nuk e hiqni atë nen që hap udhën e martesës homoseksuale, ne vetë nuk do e votojmë dhe ashtu si ambasadori amerikan i bën thirrje ndërgjegjes së secilit, unë i bëj thirrje ndërgjegjes dhe formimit njerëzor të çdo deputeti që të mos votojë asnjë ndryshimi që çon në ndryshimin e modelit tonë social. Këtu nuk flitet më për ndërhyrje në ligjin themelor të shtetit, por për ndërhyrje në rendin shoqëror. Familja është bërthama e shoqërisë së sotme shqiptare. Nëse keni ndër mend të shpikni një rend të ri shoqëror në këtë vend, ne nuk na keni me vete. Përse more zotërinj duhet të na çoni tek muri për një gjë që shqiptarët në mënyrë dërrmuese e kundërshtojnë”.*

Subjekti ankues informon se: “Statusi i deputetit është i tillë që jo vetëm formëson opinionin publik, por ndikon në formimin e praktikave, kritereve, etj, që mund të jenë diskriminuese për shkak të statusit të posaçëm që Kushtetuta dhe ligji i jep. Mbi të gjitha deputeti është ligjvënës, pra ka një ndikim të drejtpërdrejtë mbi të gjitha ligjet dhe politikat e Shtetit Shqiptar. Është kjo pozitë shoqërore që duke qenë e veshur me statusin e deputetit jep ndikime shumë herë më të gjata në kohë dhe hapësirë në drejtim të formësimit të opinionit publik kundër komunitetit LGBT. Në këtë aspekt të gjitha fjalimet, deklaratat dhe thëniet e një deputeti nuk përbëjnë thjesht një plotësim ose ushtrim të drejtës së fjalës dhe lirisë së shprehjes, por ndikimi i tyre e kapërcen kufirin e të drejtave personale ose individuale, duke i kthyer ato në atakuese të drejtpërdrejta të të drejtave dhe lirive themelore të personave të tjerë, sidomos atyre me status më të disavantazuar në shoqëri, siç janë personat LGBT. Duke patur parasysh se në bazë të Kushtetutës së Shqipërisë të gjithë janë të barabartë përpara ligjit, edhe M.D ka të njëjtat përgjegjësi përpara Kushtetutës si çdo individ tjetër në Republikën e Shqipërisë. Në këtë drejtim shtetasi M.D, deklaratën: *“Po ju drejtohem atyre që besojnë pak, ose aspak, që janë jo praktikantë apo laikë. Ky ndryshim kushtetues që po na e imponojnë do snobë që aplikojnë për projekte hedh në erë familjen dhe familjet e tjera që dalin nga kjo familje, hedh në erë shoqërinë e natyrisht atë që ne e konceptojmë Atdhe. Nuk ka kjo lidhje me reformën, aspak, por është një tjetër eksperiment pionier që do të bëhet mbi shqiptarët. Ju kanë zgjedhur si projekt pilot. Familjet tuaja si kavje”,* nuk mund ta bëjë në foltoren apo sallën e Kuvendit të Shqipërisë, i cili paguhet nga të gjithë taksapaguesit e vendit”.

Përmes kësaj ankese, subjekti ankues, “Ambasada Pink-LGBT Pro Shqipëri”, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të dënojë M.D me gjobë, bazuar në nenin 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Bazuar në nenin 33/1 të ligjit nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, kanë të drejtë të paraqesin ankesë para Komisionerit edhe organizatat me interesa legjitimë që pretendojnë diskriminim në emër të disa personave. Në bazë të nenit 3/9 të ligjit nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, “organizatat me interesa legjitime”, janë ato organizata të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit. Sa më sipër, Komisioneri konstaton se subjekti ankues “Ambasada Pink-LGBT Pro Shqipëri”, legjitimohet për të paraqitur ankesë përpara Komisionerit, si një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim për një grup personash. Si pasojë ankesa iu nënshtrua shqyrtimit të plotë.

Barazia përpara ligjit është një parim kushtetues i sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë¹. Shqipëria ka nënshkruar njëkohësisht Konventën Evropiane për

¹ Neni 18 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: *“ Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.”*

Mbrojtjen e të Drejtat të Njeriut dhe Lirive Themelore, e cila në nenin 14², garanton parimin e barazisë dhe detyron shtetet anëtare që të garantojnë gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë pa diskriminim, si dhe Protokollin Nr. 12 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, i cili i detyron shtetet anëtare të garantojnë gëzimin pa diskriminim të të drejtave dhe lirive të përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit seksual janë shkaqe të cilat gëzojnë mbrojtje nga ligji dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

M.D, nëpërmjet përgjigjes të publikuar në rrjetet sociale në datë 15.08.2016 është shprehur që heq dorë nga mbrojtja që i ofron neni 73/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin shkruhet se: *“Deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna prej tij në ushtrim të funksionit”*, dhe ka zgjedhur që të sqarojë opinionin publik në lidhje pozicionin e saj në lidhje me diskriminimin për fjalën e lirë dhe bindjen e ndryshme në tempullin e fjalës së lirë, në Kuvendin e Shqipërisë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

² Neni 14, i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtat të Njeriut dhe Lirive Themelore : *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”*

- Me shkresën nr. 747/1, datë 02.08.2016 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektit M.D, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga subjekti ankues.

M.D, nëpërmjet një përgjigje të publikuar në rrjetet sociale në datë 15.08.2016, shpjegon se: “Si deputete e Parlamentit të Shqipërisë kam detyrim të shpreh gjithë shqetësimin tim dhe të mijëra burra e grave shqiptare, për çështje të tilla që sjellin si pasojë ndryshimin e modelit tonë shoqëror të bazuar mbi familjen tradicionale Burrë-Grua dhe fëmijët që rrjedhin nga ky bashkim. Si qenie njerëzore e lirë, si grua, si nënë, si njeri që nuk ka asnjë frikë e drojë të bërtasë për të vërtetat ku beson, kam detyrimin që t’i kërkoj secilit deputet që beson tek të njëjtat vlera, që individualisht të respektojë bindjet e veta, më së pari Besimin e tyre në Zot, Familjen e tyre dhe më pas vendimet politike të forcës ku merr pjesë. E theksoj Besimin, sepse ende paska të marrë që kujtojnë se Zoti është i ndaluar për t’u përmendur e për ta pasur pikë referimi absolute në jetën e tij, familjen e tij dhe në jetën publike po ashtu. Ka nga ata që besimin në Zot e quajnë injorancë, opium për popullin, të papërshtatshëm për ta shqiptuar në publik...e për më tepër, ruajna Zot në sallën e Parlamentit të Shqipërisë. E nderuar zonjë, Unë besoj në Zot dhe nuk duhet të kem asfare kurajo për ta pohuar publikisht e personalisht, sepse është normalitet, ndaj ta harrojë kush se mundet që besimin tim ta deklarojë të ndaluar për ta përmendur në sallën e Parlamentit a kudo qoftë. E ndjej veten po aq krenare, kur i drejtohem kolegëve e miqve të mi myslimanë e të krishterë, por edhe atyre që ende nuk e kanë gjetur Hyun në jetën e tyre, por që besojnë në vlerat e një shoqërie më të mirë, solidare e në shërbim të jetës dhe i kërkoj që të bashkojmë zërat dhe votat për të ruajtur atë pak që ka mbetur nga një model dashurie dhe ndihme që duhet t’i japim familjes shqiptare që sot është më shumë se kurrë në udhëkryq e sulmuar nga varfëria, mjerimi, mungesa e vlerave, me të cilat u rritën e u edukuan brezat. Besoj në modelin e familjes tradicionale dhe ky nuk është diskriminim për askënd. Besoj se burrë a grua lind e nuk e vlerëson dot një ditë në mëngjes, kur çohesh dhe ndjehesh se ke një gjini tjetër nga ajo që Hyu të dha, kur të solli në tokë, a rasti ta solli nga stërgjysh majmuni për ata që nuk besojnë, ndaj nuk besoj se njeriu e zgjedh gjininë, por e ka dhe e jeton, e respekton atë qetësisht. Nuk gjykoj e as marr përsipër të shoh se si e jetojnë gjindja seksualitetin e tyre e as të fshehtat e dhomës së gjumit. Bindja ime njerëzore dhe besimi im më ndalon që të diskriminoj a të përbuz dikë qoftë edhe për këtë arsye, por kjo që kërkojnë prej meje është e tepërt. Po kërkojnë të kyçin e të dënojnë fjalën time në Parlament, sepse do shoqata nuk arritën dot me dredhi qëllimin e tyre për të ndryshuar? Po kërkojnë që të diskriminohet dikush për bindjet dhe besimin e tij? Po kërkojnë të diskriminohet dikush për fjalën e lirë? Kjo nuk ndodh dhe nëse dikush mundet në histori a disekuilibër momental ta kërkojë. Mbetem përballë në anën e Familjes natyrale, Besimit dhe Fjalës së lirë”.

Bazuar në faktet e mësipërme dhe në analizë të legjislacionit në fuqi, Komisioneri vëren se:

Liria e shprehjes, është një e drejtë Kushtetuese e cila garantohet nga neni 22/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kushtetuta sanksionon se të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në të mund të kufizohen. Kushtetuta e lidhë kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore të

parashikuara në të, me detyrimin për të mos tejkaluar kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut³. Për këtë arsye, në analizën që i është bërë gjuhës të përdorur nga M.D, nëse ato do të konsideroheshin në tejkalim të lirisë së fjalës të sanksionuar në nenin 22 të Kushtetutës, i jemi referuar kufizimeve që parashikon Konventa për lirinë e shprehjes, të parashikuara në nenin 10 të saj dhe qëndrimin të mbajtur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Në nenin 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, shkruhet se: *1. "Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë". 2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve apo sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor".*

Shteti shqiptar është angazhuar për të marrë masat për luftën kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, duke formalizuar vullnetin e tij përmes nënshkrimit të Rekomandimit CM/Rec (2010)5 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës "Mbi masat për të luftuar diskriminimin mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor", miratuar në datë 31.03.2010. Komiteti i Ministrave, rekomandon shtetet që të marrin masa në drejtim të garantimit të të drejtës për jetën, sigurinë dhe mbrojtjen nga dhuna, të personave për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të tyre. Në kuadër të garantimit të kësaj të drejte, rekomandohet që: "Shtetet anëtare të marrin masat e nevojshme për të luftuar të gjitha format e shprehjes, të cilat mund të kuptohen në mënyrë të arsyeshme se prodhojnë efektin e nxitjes, shpërndarjes ose promovimit të urrejtjes ose formave të tjera të diskriminimit kundër lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transeksualëve, duke përfshirë median dhe internetin. "Fjalimet e urrejtjes" ndalohen dhe dënohen publikisht. Të gjitha masat respektojnë të drejtën themelore për lirinë e shprehjes, në përputhje me nenin 10 të Konventës dhe jurisprudencën e Gjykatës".

Pra, shohim se "fjalimet e urrejtjes" kundër personave të komunitetit LGBT, kanë të bëjnë me të gjitha format e shprehjes, të përhapura si nëpërmjet medias, të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtje, diskriminim apo armiqësi ndaj njerëzve LGBT. Vlerësimi nëse shprehje të tilla apo deklarata të caktuara do të konsiderohen si "fjalime të urrejtjes", duhet të bëhen në përputhje me lirinë e shprehjes të garantuar në nenin 10 të Konventës.

³ Neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Gjuha e urrejtjes për qëllim të Rekomandimit CRI(2016)15 përfshin përdorimin e një ose të disa formave më të veçanta të shprehjes – si psh, mbrojtja, promovimit apo nxitjes së denigrimit, urrejtje apo shpifje të një personi ose grupi personash, si dhe çdo ngacmim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim apo kërcënim i një personi ose disa personave dhe çdo justifikim të të gjithë formave të shprehjes - që është i bazuar në një listë jo shteruese të karakteristikave personale ose statusin që përfshin "raca", ngjyra, gjuha, feja apo besimi, kombësia apo origjina kombëtare ose etnike, si prejardhja, mosha, paaftësia, seksi, gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual⁴.

Duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuara në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtat të Njeriut dhe Lirive Themelore, në referim edhe të evokimit që i bëhet asaj në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë logjike edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilave bëhet interpretimi i Konventës, kanë fuqinë e Konventës.

Në fjalën e mbajtur në seancën parlamentare të datës 07.07.2016, M.D ka folur në emër të subjektit politik PDIU⁵ dhe ka akuzuar, F.Xh, si drejtues i komisionit të reformës në drejtësi dhe E.R si kreun e shumicës në parlament për mos diskutimin paraprak të propozimit për ndryshimet kushtetuese në lidhje me martesat mes të njëjtit seks: *“Sot, jam këtu për të folur në lidhje me një çështje thelbësore, me ndryshimet kushtetuese që po bëhen në kuadër të reformës në drejtësi. Brenda kësaj pakete pa kurrfarë diskutimi, ka hyrë edhe shtegu që të çon në martesat homoseksuale. Përse dëshironi që votën time dhe votat e grupit të deputetëve të PDIU-së të jenë kundër”*.

M.D deklaroi më tej se: *“Këtu nuk flitet më për ndërhyrje në ligjin themelor të shtetit, por për ndërhyrje në rendin shoqëror. Familja është bërthama e shoqërisë së sotme shqiptare. Po ju drejtohem atyre që besojnë pak, ose aspak, që janë jo praktikantë apo laikë. Ky ndryshim kushtetues që po na e imponojnë do snobë që aplikojnë për projekte hedh në erë familjen dhe familjet e tjera që dalin nga kjo familje, hedh në erë shoqërinë e natyrisht atë që ne e konceptojmë Atdhe”*.

M.D akuzohet nga organizata “Ambasada Pink-LGBT Pro Shqipëri” sepse deklarata e saj, e bërë në kuvendin e Shqipërisë dhe ndarë masivisht në median e shkruar dhe vizive, e vendos komunitetin LGBT në kushte jo të favorshme për shkak të orientimit seksual.

Referuar fjalës në shqyrtim të M.D të mbajtur në Kuvendin e Shqipërisë në datë 07.07.2016 është e qartë që nuk përmban shprehje që synojnë të nxisin urrejtje, qëndrime denigruese apo veprime të dhunshme ndaj komunitetit LGBT. Qëndrimi i M.D është në përshtatje me vendimin e

⁴ Përkthim i Komisionerit. ECRI General Policy Recommendation No.15 “On combating hate speech” CRI(2016)15. Adopted on 8 December 2015. B.9 Definition (s).

⁵ Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet.

GJEDNJ-së në çështjen Handyside v. Mbretërisë së Bashkuar⁶ në të cilin Gjykata bën një dallim mes një nxitjeje serioze për ekstremizëm dhe të drejtës së individëve për të shprehur këndvështrimin në mënyrë të lirë. Ashtu siç është shprehur Gjykata: *“në funksionet e veta mbikëqyrëse e detyrojnë atë t’i kushtojë vëmendje të madhe, parimeve që karakterizojnë një “shoqëri demokratike”. Liria e shprehjes përbën një nga themelet bazë të një shoqërie të tillë, një nga kushtet bazë për progresin e saj dhe për zhvillimin e çdo njeriu”*⁷.

GJEDNJ ka përcaktuar parametrat që do të bënin të mundur të karakterizonin “gjuhën e urrejtjes” në mënyrë që ta përjashtonin nga mbrojtja e saj përmes lirisë së shprehjes. Në çështjen Faruk Temel v. Turqisë, GJEDNJ ka theksuar në veçanti që subjekti ka folur si përfaqësues politik dhe anëtar i parlamentit, dhe ka prezantuar qëndrimet politike të partisë së tij në çështje të veçanta me interes të përgjithshëm. GJEDNJ mori qëndrimin se fjala e tij, marrë në përgjithësi, nuk kishte nxitur të tjerët në përdorimin e dhunës, rezistencës së armatosur dhe nuk ka arritur deri tek gjuha e urrejtjes⁸.

Në çështjen Castells v. Spanjës 1992, GJEDNJ në hetimin e kushtit se ndërhyrja ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, është shprehur: *“Ndërsa liria e shprehjes është e rëndësishme për këdo, është veçanërisht e tillë për një përfaqësues të zgjedhur nga populli. Ai përfaqëson elektoratin e tij, tërheq vëmendjen për preokupimet e tyre dhe mbron interesat e tyre. Liria e shtypit i jep publikut një nga mjetet më të mira për të zbuluar dhe krijuar një mendim mbi idetë dhe qëndrimet e drejtuesve politikë. Në veçanti, kjo liri i jep politikanëve mundësinë për të reflektuar dhe komentuar mbi preokupimet e mendimit publik; kështu, mundëson cilindo që të marrë pjesë në debatin e lirë politik, i cili qëndron në thelb të konceptit të një shoqërie demokratike”*⁹.

Referuar fjalës në shqyrtim, mund të themi se M.D e ka të qartë rëndësinë e një politikani për të shprehur opinionin e tij në lidhje me ndryshimet e rëndësishme për të cilat po diskutohej dhe ka shprehur qëndrimin e saj, duke bërë argumentim të qartë të arsyes për kundërshtimin e ndryshimeve kushtetuese. Në vlerësim të Komisionerit, synimi i M.D nuk ka qenë diskriminimi dhe përhapja e urrejtjes ndaj komunitetit LGBT por ka shprehur qëndrimin dhe bindjet e saja kur është shprehur se: *“Besoj në modelin e familjes tradicionale dhe ky nuk është diskriminim për askënd..... Bindja ime njerëzore dhe besimi im më ndalon që të diskriminoj a të përbuz dikë qoftë edhe për këtë arsye, por kjo që kërkojnë prej meje është e tepërt”*.

Komisioneri vlerëson se, është e rëndësishme që të merren parasysh kushtet e veçanta që i bashkëngjiten jetës politike të një deputeti, që është në të drejtën e tij për të njohur zgjedhësit me pikëpamjet dhe qëndrimet e tij.

⁶ Handyside v. United Kingdom (application no. 5493/72, datë 07.12.1976.

⁷ Handyside v. United Kingdom (application no. 5493/72, datë 07.12.1976, paragrafi 49, përkthim i Komisionerit.

⁸ Faruk Temel v. Turkey (application no. 16853/05, datë 01.02.2011. ECHR, Factsheet – Hate speech, page 6.

⁹ Udhëzues për implementimin e nenit 10 të KEDNJ, M.Macovei, faqe 42-43.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se debati i shëndoshë e i hapur në një shoqëri pluraliste nuk mund të arrihet pa ruajtje të fortë dhe të gjithanshme të së drejtës së lirisë së shprehjes. Sipas standardeve përkatëse të Këshillit të Evropës, edhe kufizimet nga e drejta synojnë ti shërbejnë interesit më të mirë të një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Qasja e traktateve përkatëse, kërkon të krijojë hapësirë për një angazhim kritik dhe për debat ndërmjet grupimeve me qëndrime të ndryshme dhe të pozicionuara ndryshe në shoqëri, dhe të sigurojë në të njëjtën kohë se hapësira mbetet tolerante dhe nuk ndikohet nga urrejtja.

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se fjala e M.D e mbajtur në Kuvend në datë 07.07.2016, gjuha e përdorur dhe qëllimi i saj nuk ka qenë që të nxisë urrejtje apo qëndrim diskriminues dhe shprehjet e përdorura nuk janë të atij niveli që të nxisin qëndrime diskriminuese apo veprime të dhunshme ndaj komunitetit LGBT.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a) dhe c), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit “Ambasada Pink-LGBT Pro Shqipëri”, e përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, A.H, nga ana e M.D, për shkak të “identitetit gjinor” dhe “orientimit seksual”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI